



**“Diversifikimi i zërave në gazetari”
Bursat për Gazetari 2025
Udhëzime për aplikuesit/et**

Pse kjo thirrje?

Kosovo 2.0 (K2.0) është medie me bazë në Prishtinë, e përkushtuar në prodhimin e gazetarisë shpjeguese dhe kontekstuale, ku rrëfimtaria nuk ka të bëjë vetëm me dokumentimin e botës përreth nesh, por edhe kontribuon në riimagjinimin e saj.

E themeluar në vitin 2010 si platforma e parë e blogjeve në Kosovë, K2.0 u zgjerua dhe u konsolidua si një zë kritik dhe i besueshëm gazetaresk në vend e përtej. Përgjatë viteve, K2.0 ka botuar një varg revistash të shtypura, përpara se të kalonte në një model të revistës online. Vazhdimisht kemi organizuar një gamë të larmishme ngjarjesh publike dhe nismash për edukimin joformal, të cilat i shohim si qenësore për misionin tonë më të gjerë gazetaresk.

Në janar 2023, filluam zbatimin e projektit “[Diversifikimi i zërave në gazetari](#)”, projekt i financuar nga Bashkimi Evropian, që synon promovimin e pluralizmit medial në Kosovë, [luftimin e dezinformimit](#) dhe ndërtimin e kapaciteteve të mediave, rinisë dhe gazetarëve/eve të rinj/eja që angazhohen në prodhimin e përmbajtjeve gazetareske, të cilat u përmbahen standardeve më të larta profesionale.

Në peizazhin e sotëm medial, ku cilësia redaktoriale, pavarësia dhe pluralizmi shpesh lihen në rend të dytë, ne i kuptojmë vështirësitë me të cilat përballen gazetarët/et, veçanërisht ata/o që janë të rinj/reja e që janë në filllet e karrierës. Shumë prej tyre u mungojnë shkathtësitë, hapësira apo mundësitë e nevojshme për të prodhuar përmbajtje gazetareske të cilësisë së lartë. Programi ynë i Bursave për Gazetari është krijuar për ta trajtuar këtë problem drejtpërdrejt, **duke ofruar hapësirë për zërat e rinj që të kontribuojnë në prodhimin e përmbajtjeve gazetareske inovative, interesante dhe domethënëse.**

Rreth programit

Që nga viti 2018, programi ynë i Bursave për Gazetari synon t’i fuqizojë gazetarët/et që janë në mes të karrierës, t’i mbrojnë interesat e atyre që heshten, marginalizohen, përçahen dhe përjashtohen. Këtë qëllim e arrijmë duke ofruar **trajnime, mentorim dhe mbështetje financiare për gazetarët/et dhe profesionistët/et e medias në fillimet ose në mes të karrierës së tyre.** Pjesëmarrësit/et e kanë mundësinë të shkruajnë artikuj të gjatë, që [shpërblehen me çmime](#), me pikëpamje të të drejtave të njeriut, nën mbikëqyrjen e redaktorëve/eve me përvojë. Artikujt do të botohen në revistën K2.0.

Me fillim nga muaji maj deri në dhjetor 2025, bursistët/et që përzgjidhen do të marrin:



1. **Një program trajnimi gjithëpërfshirës**, që përbëhet nga tetë ditë punëtori intensive brenda dy muajsh. Këto punëtori do t'i mbulojnë si aftësitë teknike ashtu edhe konceptet teorike, duke u përqendruar veçanërisht në etikën gazetareske dhe mjetet e nevojshme për të prodhuar përmbajtje të pavarur dhe origjinale. Synimi është të mbështeten prodhimet që bazohen në fakte, që nxisin mendime dhe analizojnë në mënyrë kritike tema që shpesh keqinterpretohen apo lihen anash. Këtu përfshihen gjithashtu ofrimi i njohurive teorike të nevojshme për raportim cilësor për tema të tilla si gjinia dhe komunitetet seksuale, pakicat etnike, çështjet e mjedisit dhe ballafaqimi me të kaluarën, si dhe i shkathtësive teknike që lidhen me formate të ndryshme të gazetarisë multimediale. Këto shkathtësi përfshijnë teknikat e hulumtimit dhe intervistave, shkrimi, montim, prodhimi i videove dhe fotografive. Trajnimi i ofruar për pjesëmarrësit/et e përzgjedhur do të përshtatet për të përmbushur nevojat e tyre specifike dhe projektet gazetareske.
2. **Një program mentorimi tetë-mujor**, që u mundëson pjesëmarrësve/eve zhvillimin e artikujve të tyre nën udhëzimin e redaktorëve/eve të K2.0. Qasja gazetareske e K2.0 i kushton një rëndësi të veçantë redaktimit dhe rritjes së bashkëpunimit mes autorëve/eve dhe redaktorëve/eve për t'u thelluar dhe t'i shtjelluar temat e artikujve. Gjatë gjithë programit, pjesëmarrësit/et do të përfitojnë nga mbështetja dhe mbikëqyrja e vazhdueshme, duke marrë udhëzime që nga fazat fillestare të zhvillimit të tregimit deri në përfundimin e tij. Kjo qasje siguron një transferim të plotë dhe të vazhdueshëm të aftësive në prodhimin e përmbajtjeve gazetareske të cilësisë së lartë. Si pjesë e mentorimit të tyre, pjesëmarrësve/eve do t'u kërkohet të paraqesin raporte të ecurisë së punës dhe një raport përfundimtar, që ofron hollësi rreth punës së tyre.
3. Gjithsej **1,500 euro bruto** për prodhimin e përmbajtjes gazetareske si pjesë e programit, për t'u botuar në revistën K2.0. Kjo shumë bruto është subjekt i zbritjeve sipas legjislacionit në fuqi, duke përfshirë tatimin mbi të ardhurat personale dhe kontributet e pensioneve. Shuma mbulon të gjitha shpenzimet që pjesëmarrësi/ja do t'i ketë gjatë prodhimin e historisë së tyre.

Ndërsa secili/a pjesëmarrës/e do të jetë autor/e e një artikulli gazetaresk si pjesë e programit, ata/o gjithashtu do të inkurajohen t'i mbështesin artikujt e kolegëve/eve të tyre pjesëmarrës/e. Kjo **qasje bashkëpunuese** nxitë të mësuarit në formate dhe tema të ndryshme.

Pjesëmarrësit/et që përzgjidhen pritet të angazhohen plotësisht në të gjithë pjesët përbërëse të programit dhe t'i përmbushin rezultatet e tyre në kohë dhe në mënyrë gjithëpërfshirëse, siç specifikohet në këtë dokument. **Dështimi për t'i përfunduar me sukses të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë e përshkruara në kuadër të Bursës për Gazetari 2024 do të çojë në ndërprerjen e kontratës dhe humbjen e të gjitha privilegjeve të programit, përfshirë edhe përfitimet financiare.**

Çfarë po kërkohet?



Nëpërmjet programit tonë, synojmë ta mbështesim prodhimin e **artikujve me ndikim që trajtojnë çështje urgjente dhe ndërlidhen me të drejtat e njeriut**. Këto çështje përfshijnë, por nuk kufizohen në, barazinë gjinore, të drejtat LGBTIQ+, të drejtat e pakicave etnike, të drejtat e rinjve/rejave, të drejtat mjedisore, të drejtat e punëtorëve/eve dhe të drejtat civile. Inkurajohen propozimet për artikuj që trajtojnë fertilizimin in vitro (IVF), të drejtat për abort, shëndetin riprodhues dhe të drejtat pronësore të grave.

Përzgjedhja juaj varet nga prezantimi i një ideje bindëse rreth përmbajtjes që mendoni ta zhvilloni. Prandaj, në aplikimin tuaj, duhet ta saktësoni qartë një çështje ose temë të caktuar brenda fushës që përzgjidhni.

Në K2.0, ne vlerësojmë llojllojshmërinë e rrëfimitarisë. Si i tillë, çdo pjesëmarrës/e pritët të prodhojë artikull shtjellues në një nga formatet e mëposhtme sipas zgjedhjes së tyre:

1. Format i shkruar **Gjerë e gjatë** (deri në 4,000 fjalë),
2. **Dokumentar i shkurtër** (10 deri në 20 minuta),
3. **Ese fotografike** (15 deri në 20 fotografi të shoqëruara me tekst), ose
4. **Storie multimediale** (integrimi i tekstit të shkruar me përmbajtje fotografike, video dhe/ose audio).

Aplikimi juaj duhet ta dëshmojë bindshëm rëndësinë e përmbajtjes që doni ta prodhoni, si dhe pse formati i përzgjedhur është i përshtatshëm për ta përçuar në mënyrë efektive rrëfimin. Kjo përfshin prezantimin e një qasjeje origjinale ndaj aspekteve hulumtuese, raportimit dhe prodhimit të temës, duke theksuar rëndësinë dhe inovacionin si në format ashtu edhe në përmbajtje. Propozimet për përmbajtje mund të trajtojnë çështje kulturore, artistike ose politike, por duhet të mbajnë një qasje dhe pikëpamje të qartë dhe të ndjeshme ndaj të drejtave të njeriut.

Për më tepër, propozimet duhet të trajtojnë një çështje me kontekst brenda Kosovës, duke i ofruar përparësi çështjeve që përqendrohen në nivel lokal.

Të gjitha propozimet duhet t'i përmbahen afatit kohor prej katër muajsh për prodhimin e artikujve. Dorëzimi i propozimeve me afat kohor më të shkurtër ose më të gjatë mund të rezultojë në përjashtim nga shqyrtimi.

Deri në fund të programit, artikujt e prodhuar do të përkthehen ose do t'u vendosen titra (për përmbajtjet multimediale) në gjuhët shqipe, angleze dhe boshnjake/kroate/serbe dhe do të botohen në revistën Kosovo 2.0.

Për t'i shikuar artikujt që janë publikuar nga bursistët tanë të kaluar, ju lutemi klikoni në butonat më poshtë.



2018

2019

2020

2023

2024

Si të aplikoni

Nëpërmjet kësaj thirrjeje, qëllimi ynë është ta mbledhim një grup të gazetarëve/eve dhe profesionistëve/eve të rinj/reja apo në filllet e karrierës së tyre, nga sfera të ndryshme, të cilët/at kanë pasion raportimin që përqendrohet te të drejtat e njeriut dhe ka në qendër njerëzit. I inkurajojmë gratë dhe anëtarët/et e pakicave seksuale dhe etnike të aplikojnë.

Për t'i përmbushur kriteret e aplikimit, aplikantët/et duhet:

1. Të jenë shtetas/e kosovarë/e, që aktualisht banojnë në Kosovë.
2. Të jenë të grupmoshës 18-35 vjeç.
3. Të kenë të paktën dy vite përvojë profesionale në gazetari.

Përfituesit/et e kaluar/a të programit të Bursave të K2.0 nuk kanë të drejtë të aplikojnë.

Afati i fundit për të aplikuar është **25 prill 2025**. Aplikacionet e kompletuara duhet të dorëzohen si dosje elektronike (në format Word ose PDF) në: <info@ktwopointzero.com> me emërtimin "Aplikimi për Bursë për Gazetari".

Për të qenë korrekt, **ne nuk mund të pranojmë aplikimet që dorëzohen pas afatit, as nuk mund ta lejojmë të shtoni apo të zëvendësoni dokumentet që mungojnë ose janë të pasakta pasi të ketë kaluar afati.**

Për t'u marrë parasysh, aplikacioni juaj duhet të përfshijë:

1. **Formulari i aplikimit** i plotësuar tërësisht dhe sipas kërkesave.
2. **CV**, që vërteton një vit përvojë profesionale dhe/ose dy vjet të përfunduara të arsimit universitar.
3. **Kopje e skanuar e letërnjoftimit.**
4. **Portfolio me punë të mëparshme.** Portfolio juaj duhet të përfshijë një listë me të paktën dy përmbajtje gazetareske që janë botuar më parë, bashkë me vegëz elektronike. Të paktën njëri nga shembujt duhet të jetë në të njëjtin format të shkrimit që keni përzgjedhur në aplikimin tuaj. Nëse dëshironi të jepni shembuj të botimeve të shtypura, që nuk janë të qasshme në internet, ju lutemi ofroni një kopje të skanuar të punës suaj të botuar.
5. Vetëm për aplikantët/et e punësuar, **një letër mbështetëse nga punëdhënësi/ja e juaj.** Aplikantët/et e punësuar duhet të jenë në gjendje t'i kushtojnë kohë programit, duke përfshirë punëtoritë e trajnimit dhe takimet me redaktorët/et. Prandaj, një letër mbështetëse nga punëdhënësi/ja juaj, duke miratuar shprehimisht pjesëmarrjen tuaj të plotë në programin e Bursave, duhet të përfshihet në dosjen e aplikimit.



Aplikantët/et janë posaçërisht përgjegjës për të siguruar që dokumentet e tyre të paraqitura, përfshirë çdo vegëz elektronike, të jenë lehtësisht të lexueshme dhe të qasshme. Po ashtu, duhet të sigurohen që të gjitha pjesët e formularit të tyre të aplikimit janë plotësuar në tërësi, dosja e aplikimit është e plotë dhe informacioni i dhënë është i qartë, i saktë dhe në përputhje me udhëzimet. Dështimi për t'i përmbushur këto kërkesa mund të rezultojë në përjashtim nga shqyrtimi.

Çdo aplikant/e mund të paraqesë vetëm një propozim. Aplikimet mund të dorëzohen në gjuhën shqipe, angleze ose boshnjake/kroate/serbe.

Çdo pyetje lidhur me hollësitë e programit të Bursës ose rreth përgatitjet së dokumenteve për aplikim mund të dërgohet në: <info@ktwopointzero.com>, më së voni deri më **10 prill 2025**, me emërtimin "Pyetje rreth Bursës së Gazetarisë".

Për të ruajtur paanësinë dhe transparencën, ju lutemi ta keni të qartë se **ne nuk mund t'iu japim komente mbi përmbajtjen e propozimit tuaj përpara dorëzimit tuaj.**

Si do ta vlerësojmë aplikimin tuaj

Propozimi juaj do të vlerësohet bazuar në kriteret e mëposhtme:

1. Kualifikimet dhe përvoja e aplikantit/es (maksimumi 30 pikë)
2. Rëndësia e përmbajtjes së propozuar (maksimumi 30 pikë)
3. Originaliteti i propozimit të stories (maksimumi 30 pikë)
4. Mundësitë e realizimit të propozimit të stories (maksimumi 10 pikë)

Një juri e përbërë nga tre anëtarë/e të ekipit të K2.0 do ta vlerësojnë propozimin tuaj.

Përderisa cilësia e propozimit tuaj mbetet mjeti themelor i vlerësimit, juria do t'i kushtojë gjithashtu vëmendjen e duhur llojllojshmërisë gjeografike dhe tematike të storieve të propozuara. Parimet e mundësive të barabarta dhe gjithëpërfshirjes do të promovohen në mënyrë aktive gjatë procesit të përzgjedhjes.

Ju lutemi kini parasysh se nëse propozimi juaj zgjidhet, ne mund t'iu ftojme për një intervistë. Gjithashtu, nëse propozimi juaj përzgjidhet, ne mund t'iu kërkojmë ta përmirësoni atë. Kjo mund të përfshijë rritjen e efektivitetit të kostos, saktësimin e qasjes redaktoriale ose rritjen e ndikimit të prodhimit tuaj.

Pavarësisht nëse aplikacioni juaj është përzgjedhur apo jo, **ne do t'iu lajmërojmë lidhur me vendimin përfundimtar në lidhje me aplikimin tuaj.** Nëse dëshironi, mund të kërkonit sqarime mbi vendimin e jurisë deri në 5 ditë pune pasi iu është komunikuar ai.



Nëse nuk ka një gabim të qartë dhe objektiv në vlerësimin e jurisë, që ndikon ndjeshëm në vlerësimin e propozimit dhe mund t'i atribuohet vetëm jurisë (si për shembull gabimisht hedhjen poshtë të një aplikimi të plotë, që është konsideruar i paplotë), vendimet e jurisë nuk janë të hapura për ankesë. Në raste të tilla, është përgjegjësia e aplikuesit të dëshmojë gabimin me prova praktike dhe të pakundërshtueshme.

Çmimet e Bursës për Gazetari 2025 janë të vlefshme vetëm për vitin 2025 dhe nuk mund të shtyhen për vitet ose raundet pasuese të programit të Bursës për Gazetari.

Afati kohor

3 prill 2025	Hapja e thirrjes
10 prill 2025	Afati i fundit për dorëzimin e pyetjeve në K2.0
25 prill 2025	Afati i fundit për dorëzimin e aplikimeve
Maj 2025	Informata për aplikantët/et për vlerësimin e aplikimeve të tyre
Maj 2025	Çmimet për bursë
Qershor - korrik 2025	Trajnim për bursistët e përzgjedhur
Qershor - gusht 2025	Prodhimi i përmbajtjes gazetareske
31 gusht 2025	Dorëzimi i drafteve të artikujve
Shtator – tetor 2025	Redaktimi
Nëntor 2025	Përkthimi dhe dizajnimi
Dhjetor 2025	Botimi

Këto udhëzime janë në dispozicion në gjuhën angleze, shqipe dhe serbe. Në rast të ndonjë mospërputhjeje, versioni në anglisht do të ketë përparësi.